



KOMITETI PËR KOMUNITETE

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 02/01/23
Datë: 22. 02. 2023, ora 10⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbi Mbledhjen Parë të Rregullt të Komitetit për Komunitete, mbajtur me datën 22 Shkurt 2023, në orën 10⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Komiteti si në vijim:

1. Zejnepe Gaxherri - kryesuese, përfaqësuese (LDK),
2. Zenel Maloku - përfaqësues (AAK),
3. Eliza Pepshi - përfaqësuese (LVV), dhe
4. Valdrin Isufaj - përfaqësues (Komuniteti i Biznesit), dhe
5. Safete Shehu - përfaqësuese (OJQ Qershiza).

Mbledhjen e Parë të Rregullt të Komitetit për Komunitete e kryesoj znjsh. Zejnepe Gaxherri e cila përshëndeti të pranishmit në këtë mbledhje, si dhe prezantoi dhe kërkoi miratimin e Rendit të Ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin 2022,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2023,
4. Shqyrtimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete,
5. Informatë rreth çështjeve dhe kërkesave të komunitetit, dhe
6. Të ndryshme.

Ky Rendi i Ditës u shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika e Parë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesja znj. Zejnepe Gaxherri kërkoj shqyrtimin dhe miratimin e procesverbalit, i cili shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika Dytë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi i Raportit të Punës për vitin 2022

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Raportin e Punës së vitit 2022 të Komitetit për Komunitete, i cili u shqyrtua, ndërsa nuk pati ndonjë vërejtje apo ankesë. Pra, u konstatua së ky Raport është në rregull.

Pika Tretë e Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2023

Plani i Punës për vitin 2023 u shqyrtua dhe me pesë vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua si i tillë nga anëtarët e Komitetit për Komunitete.

Pika Katërt e Rendit të Ditës
Shqyrtimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komitetit për Komunitete

Kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri hapi diskutimin lidhur me këtë çështje, e cila u diskutua, ndërsa të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete u pajtuan që koha e mbajtës së mbledhjeve të jetë në orën 10:00, por u cekë se koha dhe datat mund të ndryshojnë me kërkesën dhe pajtimin e anëtarëve të Komitetit për Komunitete, nëse ndonjë nga datat e caktuara për mbajtjen e mbledhjeve korrespondon me datat e festave zyrtare.

Pika Pestë e Rendit të Ditës
Informatë rreth çështjeve dhe kërkesave të komunitetit

Fjalën e kërkoj znj. Safete Shehu e cila ngriti çështje e furnizimit me ujë të pijes në lagjen “Agim Ramadani”, ndërsa tha se neve na është premtuar furnizimi me ujë të pijes për secilën shtëpi, mirëpo na janë ndërtuar vetëm dy kroje të përbashkëta, të cilat as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat e banorëve të lagjes sonë, dhe se uji ka një erë dhe shije jo të mirë.

Pika Gjashtë e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Z. Zenel Maloku e kërkoj fjalën dhe tha, unë po ndërlidhem çështjen e lartcekur nga znj. Safete Shehu, dhe poashtu them se uji i pijes në lagjen “Agim Ramadani” është i pasigurt dhe i dyshimtë, dhe se ka erë dhe shije të keqe. Unë dyshoj dhe kërkoj ta di se nga vjen ky uji i pijes, sepse nuk e ka shijen e ujit të Junikut.

Dhe, kjo është një zgjidhje e përkohshme, dhe se projekti i premtuar për furnizim me ujë të pijes të realizohet sipas projektit dhe premtimeve të dhëna.

Z. Zenel Maloku tha, unë poashtu do të kërkoj që të bëhen analizat laborike të ujit të pijes.

Znj. Safete Shehu ngiti edhe çështje e zvogëlimit dhe migrimit të popullsisë në Komunën e Junikut, dhe kërkoj të di nëse ka ndonjë projekt për parandalimin e kësaj dukurie, e cila është brengë e Komitetit për Komunitete dhe brengë e Komunës së Junikut.

Z. Zenel Maloku tha, unë këto çështje do t’i ngriti në mbledhjen e Kuvendit dhe do të kërkoj përgjigjet për to.

Me kaq, kryesuesja znjsh. Zejnepe Gaxherri e shpalli të mbyllur mbledhjen e sotshme të Komitetit për Komunitete.

Procesmbajtësi,

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete,

Gëzim Geci

Zejnepe Gaxherri